



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT



Nr. 49 (31025-04489-86-2015) Regjistri Themeltar

Datë 26.06.2015 regjistrimi

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga:

GJYQTAR : Kastriot SELITA
GJYQTARE : Altina NASUEI
GJYQTAR : Artur MALAJ
GJYQTARE : Alkelina GAZIDEDJA
GJYQTARE : Rilinda SELIMI

-asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, në Tirane në datë 06.11.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr. 49 (31025-04489-86-2015) regjistri themeltar, datë 26.06.2015 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS:

Përparim Hoxha, i datëlindjes 27.08.1943, lindur në Gjirokastrë, banues në Rruga e Dibrës, pranë Farmacisë 10, Tiranë.

Andrea Matua, i datëlindjes 24.07.1944, lindur në Vlorë dhe banues në Rruga “Ali Pashë Gucia”, nr. 96, Tiranë.

Lirije Sina, e datëlindjes 22.03.1944, lindur në Tiranë e banues në Rruga “Tefta Tashko” pallati 132/1 Tiranë.

Adile Kallfa, e datëlindjes 15.12.1941, lindur në Gjirokastrë, e banuese në Tiranë.

Dragush Kurti, i datëlindjes 17.09.1941, lindur në Gjirokastrë e banues në Rruga "Aleksandër Moisiu", pallati 6/5, ap. 8 Tiranë.

Sadik Berisha, i datëlindjes 01.10.1941, banues në Rruga "Medar Shtylla", pallati 12 katësh, nr.4/1 Tiranë.

Afrim Tabaku, i datëlindjes 14.02.1944, lindur e banues në Rruga "Shyqyri Ishmi", pallati 24/6/113 Tiranë.

Të përfaqësuar në gjykim nga **avokat Erlir Puto**, avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë nr. 3385 license dhe Nr. L31186453T.

IPADITUR:

Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë, me adresë në Rruga "Xhanfize Keko" (përbalë Porcelanit), Tiranë, përfaqësuar nga av. Suela Hasani, pajisur me prokurë të posaçme të datës 06.07.2015 e nr. 368 rep e nr. 174 kol, nga Presidente e Urdhrit Diana Toma. Në mungesë të Avokaturës së Shtetit (njoftuar me shkresën nr. 49 akti, datë 14.07.2015).

NDËRHËRËS DYTËSOR: Ministria e Shëndetësisë, me adresë: Tiranë, Bulevardi "Bajram Curri" Nr.1, përfaqësuar nga znj. Emerlinda Guri dhe /ose znj. Marsela Serjani, pajisur me autorizimin e datës 27.10.2015 e nr. 4878 prot.

OBJEKTI:

1. Marrjen urgjente të masës së sigurimit të padisë për bllokimin e ekzekutimit të Vendimit të Këshillit Kombëtar të datës 29.05.2015

për ndryshimin e "Statutit të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë" përpara datës 1 korrik 2015 kur hyn në fuqi ky Statut.
2. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Kombëtar të datës 29.05.2015 për ndryshimin e "Statutit të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë".

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 9 e vijues Ligji nr. 9150, datë 30.03.2003 "Për Urdhërin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", Nenet 2, 3, 5, 6, 7, 8, 15 e vijues të Ligjit nr. 10171, datë 22.10.2004 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" nenet 29, 40 e vijues të Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", Statuti i Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë, Ligji 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi dëgjoi palët që në diskutimin përfundimtar pretenduan:

Përfaqësuesi i paditësave: pranimin e padisë sipas objektit.

Pala e paditur: pushimin e çështjes.

Ndërhyrësi dytësor: Pranimin e kërkesë padisë.

dhe shqyrtoi çështjen në tërësi.

V Ë R E N

1. Faktet e parashtruara para Gjykatës:

Paditësat janë një grup farmacistësh që janë në moshë për pension dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre si farmacistë në nivelin e drejtuesve teknikë, të punësuar me kontrata të rregullta pune pranë punëdhënësve, pronarë të farmacive përkatëse, anëtarë të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë. Paditësi Dragush Kurti ka mbushur moshën për pension, por vazhdon ushtrimin e aktivitetit si drejtues teknik në bazë të kontratës së punës lidhur me aktin noterial nr. 2872 rep., nr. 766 kol.,

datë 06.11.2014. Paditësi Afrim Tabuku, ka të drejtën e ushtrimit të profesionit si drejtues teknik në farmaci "Aniboka" Tiranë. Ai është i punësuar në bazë të kontratës individuale të punës datë 17.01.2013 lidhur ndërmjet tij dhe subjektit Fatos Kadesha. Paditësi Sadik Berisha ka të drejtën e ushtrimit të profesionit drejtues teknik pranë shpërndarësit Farmaceutik "Imi-Farma" Durrës. Ai është i punësuar pranë këtij subjekti në bazë të kontratës individuale të punës datë 01.01.2015 me punëdhënësin Imi Farma Sh.P.K. Paditësja Adile Kallfa, ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit si drejtuese teknike pranë farmacistë "Besmiri" Lezhë. Paditësja Lirije Sina ka të drejtën e ushtrimit të profesionit drejtues teknik. Momentalisht është e punësuar pranë subjektit "Omega Pharma Group" sipas kontratës së datës 05.01.1015. Paditësi Andrea Matua, ka të drejtën e ushtrimit të profesionit si drejtues teknik në Importuesin dhe Shpërndarësin farmaceutik "Biometric Albania" Tiranë. Ai është i punësuar në bazë të kontratës individuale të punës datë 05.01.2015 lidhur ndërmjet tij dhe subjektit Biometric Albania. Paditësi Përparim Hoxha ka të drejtën e ushtrimit të profesionit drejtues teknik. Momentalisht është i punësuar pranë subjektit Florfarma Sh.P K në bazë të kontratës individuale të punës datë 10.01.2014.

"Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë" si ent publik i krijuar me ligjin nr. 9150, datë 30.03.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi si ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik". Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 29.05.2015 ka vendosur miratimin e disa ndryshimeve (shtesave) në Statutin e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë. Ndër të tjera në nenin 19 të Statutit është shtuar një paragraf që në përmbajtjen e tij shprehet për shtimin e disa kriterëve për drejtuesit teknik të farmacive, përveç kushteve të vendosura në ligjin 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik". Më konkretisht disa nga kushtet e shtuara të cilat do të duhet të përmbushë çdo farmacist duke filluar nga data 1 korrik e hyrjes në fuqi të këtij akti janë:

- 1. Të mos ketë mbushur moshën e pensionit përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve; dhe*
- 2. Të jetë i punësuar me kohë të plotë në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik".*

Gjatë gjykimit të çështjes në seancën gjyqësore, Gjykata Administrative e Apelit mbi kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë bazuar në nenin 191 të Kodit të Procedurës Civile pranoi në cilësinë e ndërhyrësit dytësor Ministrinë e Shëndetësisë për të mbështetur palën paditëse duke çmuar

interesin e saj në këtë gjykim, pasi ajo është një nga organet kryesore përgjegjëse për miratimin dhe kontrollin e praktikave shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, dhe bazuar dhe në ligjin "Për Urdhrin e Farmacistëve" parashikohet bashkëpunimi i Urdhrit të Farmacistëve me Ministrinë e Shëndetësisë, si garante e ofrimit të nivelit më të lartë të formimit shkencor dhe profesional të farmacistëve, si dhe shërbimit farmaceutik në përgjithësi.

II. Pretendimet dhe palëve në proces gjyqësor:

Pala paditëse ka kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit të datës 29.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve për ndryshimin e "Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë" (shitesat në nenin 19) si të marra në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me këto pretendime:

Sipas palës paditëse, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 29.05.2015 ka vendosur miratimin e disa ndryshimeve (shtesave) në Statutin e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë. Ndër të tjera në nenin 19 të Statutit është shtuar një paragraf i cili është miratuar në kundërshtim me kompetencat e Këshillit Kombëtar dhe legjislacionin në fuqi. Ky paragraf në përmbajtjen e tij shpreh për shtimin e disa kriterëve për drejtuesit teknikë të farmacive, përveç kushteve të vendosura në ligjin "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik". Më konkretisht disa nga kushtet e shtuara të cilat do të duhet të përmbushë çdo farmacist duke filluar nga data 1 korrik e hyrjes në fuqi të këtij akti janë:

- 1. Të mos ketë mbushur moshën e pensionit veç rasteve të të vetëpunësuarve; dhe*
- 2. Të jetë i punësuar me kohë të plotë në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik.*

Parashikime të tilla në Statutin e Urdhrit të Farmacistëve janë të paligjshme si dhe çënojnë rëndë të drejtat themelore të shtetasve, në ushtrimin e lirë të profesionit pa kufizime. Në këtë rast Urdhri ka marrë një vendim që çënon të drejtat themelore të anëtarëve të tij, duke ndaluar të punojnë ata njerëz që kanë kontribuar gjithë jetën e tyre në farmaceutikën shqiptare, duke i ndaluar këta që të sigurojnë mjetet e tyre të jetesës, megjithëse janë në gjendje të aftë për punë. Një organ i zgjedhur i një entit, nuk mund të vendosë për fatin dhe jetën e njerëzve që punojnë me ndershmëri e dinjitet, duke i privuar ata nga e drejta e punës dhe ajo e sigurimit të mjeteve të jetesës.

Ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" përcakton në mënyrë shteruese të gjitha kriteret të cilat duhet të plotësojë drejtuesi teknik. Konkretisht kriteret e përcaktuara në ligj në nenin 29 të tij për *Drejtues farmaceutik me shumicë* janë:

- *Të zotërojë diplomë universitare;*
- *Të ketë përvojë pune prej dy vjetësh; dhe*
- *Të jetë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.*

Gjithashtu në nenin 40 kriteret për *Drejtues Teknik Farmacie* janë:

Të zotërojë diplomën universitare të Fakultetit të Farmacisë, të jetë anëtar i urdhrit të farmacistëve dhe ta ushtroj këtë rol vetëm për një farmaci.

Pra në kriteret e përmendura në ligjin specifik asnjë nga kushtet e shtuara në Statutin e Urdhrit të Farmacistëve nuk përfshihet. Parashikimi i kritereve si puna me kohë të plotë vetëm për farmacinë ku do të punojë si drejtues teknik apo kufizimi i së drejtës së ushtrimit të profesionit pas daljes në pension është një kufizim i së drejtës së ushtrimit të profesionit, i bërë në tejkallim të parashikimit ligjor. Për më tepër amendimi i kritereve në ligj mund të bëhet vetëm nëpërmjet ligjit dhe jo statutin të një entit publik.

Së dyti, edhe ligji "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" në nenin 6 të tij parashikon se kriteret për ushtrimin e profesionit të rregulluar (profesion në të cilin përfshihet edhe farmacistët) do të përcaktohen në atë ligj ose në ligje të tjera të veçanta. Pra edhe në këtë rast parashikimi apo kufizimi i kritereve do të bëhet në legjislacion specifik dhe jo nëpërmjet statuteve të miratuara.

Së treti: ligji nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" parashikon si kompetencë të Këshillit të Kombëtar të Farmacistëve vetëm përcaktimin e kritereve për pranimin e farmacistëve në Urdhër. Gjithashtu në kompetencat e Këshillit të përcaktuara në nenin 13 të ligjit, veprimtaria e tij është më shumë administruese e mbikqyrëse se sa kriter përcaktues, për më tepër kur këto kritere janë të përcaktuara në ligj. Neni 9 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se organet e administratës publike (ku përfshihet edhe entit publik) e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në

fuqi, brenda kompetencave që iu janë dhënë atyre konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Në qoftë se do t'i referoheshim qëllimit të ligjit "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 1 të tij përcaktohet si qëllim ruajtja e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe zbatimi i rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike. Neni 2 parashikon mbikqyrjen e zbatimit të detyrave profesionale, mbikqyr zbatimin e Kodit të Deontologjisë etj. Pra në tërësinë e tij qëllimi i ligjvënësit nuk ka qënë që t'i japë entit publik të drejtën të kufizojë ato kritere ligjore të përcaktuara në ligje të vecanta, siç është kategoria drejtues teknik. Pra enti publik ka detyrimin e respektimit të kritereve të vendosura në ligj dhe nuk mund të dalë jashtë kuadrit të kompetencave ligjore. Më tej neni 3 i po këtij ligji parashikon detyrimin e tij për mbrojtjen e farmacistëve nga veprimet arbitrare të administratës publike ose private për ushtrimin e profesionit. Vendosja e kritereve shtesë për ushtrimin e profesionit të drejtuesit teknik është një veprim arbitrar që kufizon thelbësisht të drejtën e ushtrimit të lirë të profesionit. Edhe pse mund të pretendohet se këta farmacistë vazhdojnë ta ushtrorjnë profesionin si farmacist, përsëri ky mbetet një justifikim që do të mbulojë situatën reale. Ligji e parashikon në mënyrë të qartë dallimin farmacist dhe drejtues teknik. Pra drejtuesi teknik është ai që përgjigjet për veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillohet në farmaci. Pra edhe pse këta farmacistë kanë të drejtën e ushtrimit të profesionit si farmacist, i mohohet një e drejtë tjetër themelore, ushtrimi i profesionit si drejtues teknik.

Së katërti: me ndryshimet në ligjin nr. 9150, datë 30.10.2003, amenduar nga ligji 128/2014, detyra e urdhrin të farmacistëve është të garantojë që anëtarët e tij të përmbushin detyrimet e programit të riçertifikimit të vendosura nga institucioni përkatës. Pra kualifikimi i farmacistëve dhe kriteret se mbi ç'baza do ta ushtrorjnë veprimtarinë varet vetëm nga përcaktimi ligjor. Gjithashtu edhe kufizimi i kësaj të drejte, në zbatim të parimit të ligjshmërisë, duhet të bëhet vetëm në rrugë ligjore.

Së pesti, edhe sikur Këshilli Kombëtar të kishte kompetencë të përcaktonte kritere të tjera përveç atyre ligjore, përsëri nuk mund të dilte jashtë kuadrit ligjor, por të shtjellonte më tej ato përcaktime ligjore. Kufizimi i së drejtës për të punuar me daljen në pension jo vetëm është jo ligjore, por edhe antikushtetuese. Ky Këshill pa bazë ligjore ka vendosur për një kufizim të tillë thelbësor duke bërë dallim ndërmjet personave të vetëpunësuar dhe atyre të punësuar. Në qoftë

se Urdhri i Farmacistëve, si rol ligjvënësi që ka marrë pretendon mbrojtjen e interesit publik atëherë duhe të aplikonte të njëjtin standard si për të punësuarit si për të vetëpunësuarit. Në qoftë se një farmacist është i aftë të ushtrojë detyrën e drejtuesit teknik edhe pas daljes në pension nuk ka asnjë shkak ligjor që ta pengojë atë në të drejtën e tij. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 49 parashikon se secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, duke pasur të drejtë të zgjedhë vendin e punës, profesionin etj. Pra ky kufizim është antikushtetues. Gjithashtu edhe neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet vetëm me ligj. Pra kjo dispozitë nënkupton se për sa kohë i punësuar apo i vetëpunësuar po ushtron një veprimtari të ligjshme si dhe i kualifikuar profesionalisht, nuk mundet që t'i kufizohet kjo e drejtë pa një bazë ligjore.

Kodi i Proçedurave Administrative në nenin 11 të tij parashikon udhëheqjen e veprimtarisë së administratës publike nga parimi i barazisë dhe proporcionalitetit. Nuk mund të flitet për barazi në kushtet kur dy farmacistë, njëri që ka aktivitetin e tij dhe tjetri që është i punësuar, njëri të punojë edhe pas moshës së daljes në pension dhe tjetri të punojë deri në daljen në pension. Nuk mund të përcaktohen kriteret e tjera për drejtuesit teknikë në mënyrë joproporcionale. Vendosja e detyrimit të punës me kohë të plotë në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik është po ashtu një kufizim jo ligjor dhe i pajustificueshëm. Ligji "Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik" ka parashikuar të drejtën e drejtuesit teknik që veprimtaria e tregtuesit me shumicë apo e farmacisë thjesht mund të ushtrohet vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar. Pra vetë ligji ka lënë mundësinë që ushtrimi i aktivitetit të bëhet edhe në praninë e farmacistit të punësuar pa qenë nevoja që të jetë gjatë gjithë kohës i punësuar aty edhe drejtuesi teknik. Ushtrimi i veprimtarisë së farmacistit i nënshtrohet parimit të konkurrencës së lirë, parim i cili qëndron në themel të sistemit ekonomik dhe si i tillë nuk mund të kufizohet.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga Urdhri i Farmacistëve se këto kriteret janë vendosur për të garantuar cilësinë e shërbimit farmaceutik, nga pala paditëse parashtrohet se:

Së pari: Urdhri i Farmacistëve i Republikës së Shqipërisë, si dhe institucione të tjera si Ministria e Shëndetësisë kanë mjete dhe metoda të tjera që mund të garantojnë kontrollin e cilësisë së shërbimit farmaceutik. Ligji për Urdhrin e Farmacistëve parashikon në nenin 17 të tij se Komisioni Disiplinor mund të marrë masa ndaj anëtarëve që kryejnë shkelje të Kodit të

Deontologjisë Farmaceutike ose gabime teknike, deri në masën e përjashtimit nga Urdhri për një periudhë tre vjeçare. Pra në bazë të ligjit Urdhrit të Farmacistëve i është lënë mundësia e kontrollit të shërbimit nëpërmjet metodave të tjera ligjore, dhe jo vendosjes së kritereve antikushtetuese dhe joligjore.

Së dyti, si ka mundësi që për personat e vetëpunësuar (edhe pse mund të jenë mbi 65 vjeç) të jenë garant të ofrimit më cilësor të shërbimit në detyrën e drejtuesit teknik dhe drejtuesit teknik të punësuar edhe pse në gjendje të mirë shëndetësore nuk janë garant të ushtrimit të profesionit në mënyrë cilësore dhe efikase? (Në lidhje për ndryshimet në nenin 19 të Statutit, është shprehur me rekomandim edhe Avokati i Popullit (Rekomandimi nr. k1/h40-5 Prot. Datë 23.09.2015) ku rekomandon konstatimin e pavlefshmërisë së pjeshme absolute të vendimit nr. 8 datë 29.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur me vendimmarrje edhe Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke i konstatuar këto ndryshime si diskriminuese dhe antikushtetuese).

Gjatë gjykimit, në cilësinë e ndërhyrësit-dytësor u paraqit edhe Ministria e Shëndetësisë, duke mbështetur qëndrimet e palës paditëse dhe shprehur qëndrimin e saj për vendimmarrjen e paligjshme dhe në tejkallim të kompetencave të veta të Urdhrit të Farmacistëve. Pra institucionet shtetërore, si garantuese të të drejtave dhe lirive të shtetasve në Republikën e Shqipërisë njëzëri kanë dalë me vendime dhe rekomandime në mbështetje të pretendimeve të paditësve. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë janë shprehur kundër vendosjes së kritereve shtesë në Statut përveç atyre të përcaktuara ligjërisht, kritere të cilat janë vendosur jo vetëm në tejkallim të kompetencave të Urdhrit të Farmacistëve, por përbëjnë kritere diskriminuese për shkak moshe dhe gjendje ekonomike (pra kriteret që dallojnë të vetëpunësuarit dhe të punësuarit, si dhe vendosja e moshës për kriter drejtuesi teknik).

Si përfundim pala paditëse pretendon Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Kombëtar të datës 29.05.2015, për ndryshimin e "Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë", konkretisht shtimi i paragrafit të neni 19 për kriteret shtesë të ushtrimit të profesionit të drejtuesve teknikë të farmacive.

Ndërhyrësi dytësor, Ministria e Shëndetësisë ka kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit të datës 29.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve për ndryshimin e "Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë" (shtesat në nenin 19) pasi është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, me këtë arsyezim:

Ministria e Shëndetësisë, ashtu si dhe Urdhri i Farmacistëve janë organe të administratës publike me kompetenca të përcaktuara qartësisht në aktet ligjore dhe garantuese të të drejtave dhe lirive themelore të individëve në veprimtarinë e tyre. Si organe publike janë të detyruara të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë që të kontribuojnë në realizimin sa më të mirë të interesave të shtetasve.

Objekti i këtij procesi gjyqësor është ngritja e pretendimeve për paligjshmërinë e vendimmarrjes së entit publik Urdhri i Farmacistëve, konkretisht vendimi nr. 8 datë 29.05.2015 të Këshillit Kombëtar të këtij Urdhri, vendim i cili kufizon të drejtën e farmacistëve në nivel drejtuesi teknik për të ushtruar profesionin. Ky vendim përmban disa kritere shtesë për cilësimin si drejtues teknik, veç parakushteve të përcaktuara në ligjin "Për barnat në Shërbimin farmaceutik".

Konkretisht parashikohet:

Çdo anëtar i Urdhrit të Farmacistëve mund të aplikojë për të qenë drejtues teknik nëse plotëson parakushtet e vendosura në ligjin "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" si dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve...".

Ministria e Shëndetësisë, si autoriteti shëndetësor kryesor përgjegjës për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, si drejtuese e politikës, organizmit dhe mbikëqyrjes së kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë është e përfshirë në zhvillimet dhe miratimet përkatëse në këtë fushë nga organe të tjera të administratës publike. Rregullimet ligjore për garantimin e një mbrojtje efikente të të drejtave të shtetasve mbeten një nga pikat ku Ministria ka interes të veçantë që i ndjek dhe jep kontributin e sa të përhershëm e për të cilat nuk mundet kurrësi të qëndrojnë indiferente.

Megjithatë si institucion, pavarësisht se në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk është organ përgjegjës për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit, si përfaqësues të interesit publik çmohet se pretendimet e ngritura nga paditësit vënë në pikëpyetje çështje themelore të funksionimit të shtetit të së drejtës e si të tilla meritojnë vëmendjen edhe të këtij Institucioni. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon si parim themelor në nenin 49 lirinë e zgjedhjes së lirë të profesionit, vendit të punës dhe sistemin e kualifikimit profesional. Kjo është një e drejtë e njeriut e si e tillë gjen kufizim vetëm nga ligjvënësi duke mos prekur thelbin e kësaj të drejte. (neni 17 i Kushtetutës). Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet vetëm me ligj. Pra kjo dispozitë nënkupton se për sa kohë i punësuari apo i vetëpunësuari po ushtron një veprimtari të ligjshme si dhe i kualifikuar profesionalisht, nuk mundet që t'i kufizohet kjo e drejtë pa një bazë ligjore. Kufizimi mund të bëhet vetëm kur veprimet janë aboslutisht të nevojshme për të mbrojtur në veçanti interesa të rëndësishme të komunitetit. Këto janë parime të shtetit të së drejtës që duhen respektuar, por në rastin konkret kufizimi është realizuar përmes një akti nënligjor, respektivisht Vendimit të datës 29.05.2015, të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve. Pra miratimi i dispozitave të kufizimit të së drejtës së ushtrimit të profesionit drejtues teknik është në kompetencë të Kuvendit dhe jo organeve të tjera të administratës publike.

Parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e administratës publike që të ushtrorjnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga organet e administratës publike duhet të jenë në pajtim me aktet me fuqi më të lartë juridike. Urdhri i Farmacistëve të Republikës së Shqipërisë si ent publik ka detyrimin ligjor t'i përmbahet kompetencave të dhëna në aktet e tjera ligjore si dhe të shprehet për ato rregullime të cilat nuk përbëjnë kufizim të së drejtës së shtetasve të Republikës së Shqipërisë për ushtrimin e profesionit. Miratimi me akt nënligjor i të drejtës së ushtrimit të profesionit si drejtues teknik përbën një nga ato të drejta kushtetuese që do të duhen të kufizohen vetëm me ligj dhe jo me akte normativ siç është vendimi i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve.

Ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" përcakton në mënyrë shteruese të gjitha kriteret të cilat duhet të plotësojë drejtuesi teknik. Konkretisht kriteret e përcaktuara në ligj në nenin 29 të tij për drejtues teknik me shumicë janë:

Të zotërojë diplomë universitare;

Të ketë përvojë pune prej dy vjetësh; dhe

Të jetë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

Gjithashtu në nenin 40 kriteret për Drejtues Teknik Farmacie janë:

“Drejtuesi teknik i farmacisë

1. Drejtues teknik i farmacisë është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i huaj, që plotëson kërkesat e mëposhtme:

a) zotëron diplomë universitare të Fakultetit të Farmacisë; për shtetasit e huaj nevojitet njësimi i diplomës universitare nga autoriteti përgjegjës;

b) ka një përvojë pune prej tre vjetësh në farmaci;

c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve;

d) drejtuesi teknik i farmacisë e ushtron këtë rol vetëm për një farmaci ”.

Pra në kriteret e përmendura në ligjin specifik asnjë nga kushtet e shtuara në Statutin e Urdhrit të Farmacistëve nuk përfshihet. Parashikimi i kriterëve si puna me kohë të plotë vetëm për farmacinë ku do të punojë si drejtues teknik apo kufizimi i së drejtës së ushtrimit të profesionit pas daljes në pension është një kufizim i së drejtës së ushtrimit të profesionit, i bërë në tejkallim të parashikimit ligjor. Për më tepër amendimi i kriterëve në ligj mund të bëhet vetëm nëpërmjet ligjit dhe jo statutit të një entit publik. Përcaktimi i kriterit të moshës së pensionit me anë të Këshillit Kombëtar, është një kufizim i vendosur nga Statuti dhe është në tejkallim të legjislacionit që rregullon ushtrimin e profesionit të farmacistëve.

Së dyti, edhe Ligji nr. 10 171, datë 22.10.2009, i ndryshuar “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” në nenin 6 të tij parashikon se kriteret për ushtrimin e profesionit të rregulluar (profesion në të cilin përfshihet edhe farmacistët) do të përcaktohen në atë ligj ose në ligje të tjera të veçanta. Pra edhe në këtë rast parashikimi apo kufizimi i kriterëve do të bëhet në legjislacion specifik dhe jo nëpërmjet Statuteve të miratuara. Neni 14 i ligjit të sipërcituar konfirmon që *Autoriteti kompetent për profesionet e rregulluara në një fushë të caktuar është ministria që mbulon fushën përkatëse.*

Se pari: Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë është krijuar bazuar në Ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" dhe funksionon bazuar në parimet e këtij ligji, Statutin e UFSH-së, Kodin Deontologjik dhe Vendimet e Këshillit Kombëtar të UFSH-së, Kuadri ligjor i mësipërm e vesh UFSH-në (Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë)

keto argumenta kryesorë mbështetës:

Pala e paditur Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë i prapësoi pretendimet e palës paditëse me

Si përfundim ndërhyrësi dytësor pretendon shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Kombëtar të datës 29.05.2015, për ndërshimin e "Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë".


private për ushtrimin e profesionit.

deyrimin e tij për mbrojtjen e farmacistëve nga veprimet arbitrare të administratës publike ose nuk mund të datë jashtë kuadrit të kompetencave ligjore. Me tej nëni 3 i po këtij ligji parashikon drejtues teknik. Për entit publik ka deyrimin e respektimit të kriterëve të vendosura në ligj dhe drejtën të kufizojë ato kritere që të përcaktojnë në ligje të veçanta, siç është kategoria deontologjike e tij. Për në tërësi e tij qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë që t'i japë entit publik të parashikon etikës, zbatuar të deyrave profesionale, mbikqyr zbatuar e Kodit të farmaceutik dhe zbatimi i rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike. Neni 2 "Shqipërisë" në nenin 1 të tij përcaktohet si qëllim ruajtja e cilësisë së lartë të shërbimit Në qoftë se do t'i referoheshim qëllimit të ligjit "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e

jane dhene keto kompetenca.

legjislationin në fuqi, brenda kompetencave që iu janë dhënë atyre konform qëllimit për të cilat përfshihet edhe entit publik) e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën dhe Neni 9 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se organi e administratës publike (ku mbikqyrëse sesa kritere përcaktues, për më tepër kur këto kritere janë të përcaktuara në ligj.

Këshillit të përcaktuara në nenin 13 të ligjit, veprimtaria e tij është më shumë administruese e përcaktimit e kritereve për pranimitin e farmacistëve në Urdhër. Gjithashtu në kompetencat e Shqipërisë" parashikon si kompetencë të Këshillit të Kombëtar të Farmacistëve veçem Se treti: Ligji nr. 9150, datë 30.10.2003, i ndërshuar "Për urdhrin e Farmacistëve në Republikën e



me një sërë kompetencash të cilat ajo i ushtron në dobi dhe mbrojtje të profesionit të farmacistit, pacientëve dhe konsumatorëve.

Së dyti: Neni 1 i ligjit 9150 përcakton shprehimisht se Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë krijohet për ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe për zbatimin e rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike.

Së treti, Neni 5 i Statutit përcakton se "Urdhëri përbëhet nga farmacistë që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e përcaktuara nga Këshilli Kombëtar për të qënë anëtarë, sipas Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrit e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë".

Së katërti: Neni 25 i Statutit përcakton Detyrat e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve dhe specifikisht në pikën 4 shprehet se "*Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve përcakton kriteret e anëtarësimit në Urdhër, dokumentacionin e anëtarësimit, modelet e certifikatave, lejet e ushtrimit të profesionit dhe çdo dokument tjetër të leshuar nga Urdhëri*".

Së pesti, Neni 7 pika 5 i Statutit përcakton shprehimisht se ndër funksionet kryesore të Urdhërit është dhënia dhe heqja e të drejtës vetjake për ushtrimin e profesionit sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar.

Së gjashti, Neni 40 pika 1 shkronja c) të Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" përcakton se "Drejtuesi teknik i farmacisë duhet te jete anëtar i Urdhrit të Farmacistëve", gjithashtu në pikën 3, shprehet se: "*Drejtuesi teknik i farmacisë është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë teknike dhe profesionale që zhvillohet në farmaci*".

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 29.05.2015 ka vendosur miratimin e ndryshimeve në Statutin e saj në mbështetje të plotë me kompetencat e këtij Këshilli si dhe legjislacionit në fuqi si në vijim cituar.

Neni 6 pika 3 të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" shprehet se "Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve përcakton kriteret për pranimin e farmacistëve në këtë urdhër." Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve harton dhe miraton Kodin e Deontologjisë Farmaceutike, si dhe statutin e Urdhrit të Farmacistëve.

Rrjedhimisht, në kuptim të Neni 116 të Kodit të Proçedurave Administrative parashikohet se "Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

a) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; (Në rastin objekt gjykimi organi është i identifikuar);

b) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; Neni 6, pika 3 të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" shprehet se "Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve përcakton kriteret për pranimin e farmacistëve në këtë urdhër, pra është ligji që ja jep këtë kompetencë.

c) Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji". Vendimi i Këshillit Kombëtar, procesverbali i Mbledhjes së Këshillit si dhe listë prezencë e anëtarëve të saj të depozituara në dosjen gjyqësore, vërtetojnë qartë se ndryshimet objekt gjykimi janë nxjerrë në përputhje me ligjin në Ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë".

Pala e paditur i ka kryer të gjitha ndryshimet në statutin konform rregullave të përcaktuara në të dhe me mbështetjen e plotë të legjislacionit në fuqi ka kryer ndryshimet duke përbushur qëllimin e saj "Për ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe për zbatimin e rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike". Ndryshimi nuk ka të bëjë me mohimin e të drejtës së punës pasi ndryshimet objekt të këtij gjykimi nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të farmacistit por me përcaktime specifike të drejtuesit teknik.

Pala paditëse e cila pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilën bazon pretendimet e saj, por ajo nuk ka depozituar asnjë provë në mbështetje të kërkesë padisë. Pretendimin i palës paditëse se miratimi i ndryshimeve statutores është në kundërshtim me kompetencat e Këshillit Kombëtar dhe legjislacionit në fuqi nuk mbështet në

prova. Për të gjitha arsyet e parashtruara më sipër, kërkohet nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pushimi i çështjes ndaj Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë.

III. Vlerësimi i Gjykatës:

i) lidhur me kushtet e pranueshmërisë së padisë.

Gjykata Administrative e Apelit kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo hyn në kompetencën lëndore të saj për gjykim bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar (në tekstin vijues ligji nr. 49/2012), sipas të cilit:

"Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;..."

Kjo çështje hyn në kompetencën funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit sipas nenit 10, shkronja "b" të ligjit nr. 49/2012 me këtë përmbajtje:

2. "Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

a)...

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj."

Në nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se:

"1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet mbi bazën e të cilave nxirren këto akte..." Në këtë normë kushtetuese janë mishëruar dy parime të rëndësishme kushtetuese: rezerva ligjore dhe parimi i epërsisë së ligjit. Mbi bazën e këtyre parimeve, aktet nënligjore nxirren vetëm nga organet e parashikuara në Kushtetutë, mbi bazën e autorizimit të shprehur në ligj dhe vetëm për që çështje që ligji përcakton se duhen rregulluar me akt nënligjor.

Referuar përkufizimit të dhënë në nenin 2, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, akt nënligjor normativ është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij.

Përkufizimi i termit "organit publik" gjendet në nenin 2, pika 6 të ligjit nr. 49/2012 sipas të cilit: "Organ publik" është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për atë kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike". Sipas ligjit nr. 8480 datë 27.05.1998 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve Publike", me ent publik do të kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike, jo shtetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik.¹

Në kuptim të përcaktimeve të nenit 1 të ligjit nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Urdhri i Farmacistëve është ent publik jobuxhetor, i cili përbëhet nga individët që ushtrojnë profesionin e farmacistit, i krijuar për ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe për zbatimin e rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike. Urdhri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe të edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit sipas kërkesave shkencore, të normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme. Sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve, si një nga

¹ Neni 1 i ligjit.

organet e tij, përcakton kriteret për pranimin e farmacistëve në këtë urdhër, harton dhe miraton Kodin e Deontologjisë Farmaceutike si dhe statusin e urdhrit të farmacistëve.²

Në kontekst të dispozitave të lartëcituara, Vendimi i datës 29.05.2015 i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve për ndryshimin e "Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë" (shtesat në nenin 19) përbën akt nënligjor normativ, pasi është nxjerrë nga një organ i entit publik i krijuar me ligjin nr. 9150, datë 30.03.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", që funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi si ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", në ushtrim të funksionit të tij publik, që vendos rregulla të përgjithshme sjelljeje sa i takon kriterëve të ushtrimit të detyrës së drejtuesit teknik, akt që nuk është shterues në zbatim.

Sa i takon legjitimitetit të palës paditëse, Gjykata vëren se për të parashtruar një kërkim në gjykim ose për këtë kundërshtuar këtë kërkim është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobja personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejtë të mohuar ose të shkatërruar dhe të drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës që përbën një nga kushtet formale të padisë në gjykimin administrativ, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës administrative, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe aktit administrativ i cili kundërshtohet si i paligjshëm. Interesi duhet të jetë aktual, domethënë se dëmi që i shkaktohet paditësit dhe që kërkohet të shmanget me padinë duhet të ketë ngjarë në kohën e ngritjes së padisë ose të vërtetohet në një kohe të ardhme shume të afërt, jo thjesht të ardhme.³ Paditësit kanë provuar interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë pasi në bazë të legjislacionit në fuqi dhe në veçanti të nenit 15 të ligjit 49/2012, ata janë persona që veprimtaria e tyre profesionale preket nga ndryshimet në statut për shkak të pretendimeve mbi cënimin e së drejtës për punë dhe ushtrimin e lirë të profesionit si farmacistë në nivelin drejtues teknikë. Në këtë mënyrë dispozitat e aktit nënligjor normativ objekt gjykimi janë të lidhura drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e tyre profesionale.

² Neni 6, pika 3 në lidhje me nenin 12 të ligjit nr. 9150, datë 30.10.2003.

³ Lidhur me interesin e ligjshëm për të ngritur padi, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 30.10.2012.

Miratimi i ligjit nr. 49/2012 ka krijuar më shumë hapësirë në kushtet e pranueshmërisë për subjektet që legjitimohen për të ngritur padi në gjykatën administrative. Sipas nenit 15 të ligjit, të drejtën e ngritjes së padisë e ka çdo subjekt që i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik apo për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik që nuk kanë formën e aktit administrativ. Kuptimin e veprimit administrativ e jep pika 7 e nenit 2 të këtij ligji, sipas së cilës “veprim administrativ” është akti administrativ, kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ. Në përkufizimet që jep ligji, “akt administrativ” është çdo akt administrativ individual dhe çdo akt nënligjor normativ.⁴

Në kuadër të tendencës së zgjerimit të rrethit të subjekteve që i drejtohen gjykatës administrative, neni 15, shkronja “d” e ligjit, ka evidentuar dy subjekte që kanë të drejtën e ngritjes së padisë për të kundërshtuar një akt normativ kur pretendohet cënimi i një interesi të ligjshëm publik të cilat janë: shoqatat dhe grupet e interesit. Në interpretim të dispozitave procedurale të lartëcituara, një subjekt i vetëm, qoftë ky edhe person fizik, legjitimohet të kundërshtojë në Gjykatën Administrative të Apelit ligjshëmërinë e aktit normativ kur provon cënimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të së drejtës së tij subjektive nga ky akt nënligjor normativ, duke respektuar format procedurale të kërkimit në objektin e padisë të listuara në nenin 17 të ligjit nr. 49/2012.⁵ Për të gjitha arsyet e renditura më lart, Gjykata Administrative e Apelit konkludon se paditësit kanë provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të së drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe aktit administrativ i cili kundërshtohet si i paligjshëm, pasi janë persona që kanë mbushur moshën ligjore për pension pleqërie dhe nuk janë të vetëpunësuar në farmacitë ku ushtrojnë detyrën e drejtuesit teknik. Për këtë arsye ata gëzojnë legjitimitet aktiv.

Në lidhje me afatin e kundërshtimit të aktit nënligjor normativ, neni 18, pika 3 e ligjit nr. 49/2012 parashikon se *padia duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit*. Gjykata Administrative e Apelit vëren se në këtë gjykim pala paditëse nga

⁴ Neni 2, pika 1 e ligjit nr.49, datë 03.05.2012.

⁵ Sipas nenit 17 të ligjit nr.49/2012: “Padia mund të ngrihet:

- a) Për shfuqizimin tërësisht ose pjesërisht të aktit administrativ;
- b) Për ndryshimin pjesërisht apo tërësisht të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;
- c) Për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ...”

pikëpamja formale pretendon shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Kombëtar të datës 29.05.2015, për ndryshimin e "Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë", akt i cili mund të goditet për paligjshmërinë që nga data 29.05.2015, kohë në të cilën ky akt nënligjor normativ ka hyrë në fuqi. Për këto arsye Gjykata konkludon se paditësit e kanë ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë brenda afatit 3-vjeçar.

ii) *lidhur me ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ:*

E drejta për punësim dhe e drejta për të zgjedhur profesionin dhe vendin e punës është përmbajtur në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si kategorizim i një prej të drejtave themelore të njerit me karakter ekonomik por edhe social, me këtë parashkrim kushtetues:

"1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose punuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional"

2. Të punëson të kësaj të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës"

Në këtë kuadër kushtetues afirmohet liria për të zgjedhur profesionin, vendin e punës dhe kualifikimin profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. E drejta për punë, parimet dhe institutet e saj, sigurojnë që askush të mos jetë i përjashtuar nga hapësira e punës. Ajo ka për qëllim krijimin e kushteve, aksesit për të punuar, duke mbuluar edhe mbrojtjen e përjashtimit të padrejtë. Në këtë kuptim, veprimet e organeve të administratës shtetërore që sjellin pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbëjnë cënim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë pasi analizon përmbajtjen e nenit 49 të Kushtetutës me frymën e qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut thekson, se përcaktimi i dhënë me Kushtetutë i të drejtës për punë përmban: *"...një detyrim pozitiv që kërkon një angazhim shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e kësaj të drejte....dhe një detyrim negativ që kërkon mosndërhyrjen*

e shtetit për të cenuar këtë të drejtë". Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese thekson se: "Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi".

Të drejtat e njeriut dhe një pjesë e parimeve të së drejtës së punës janë pasqyruar edhe në akte ndërkombëtare si Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Karta Sociale Europiane. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 4 të saj ka parashikuar ndalimin e skllavërisë dhe punës së detyruar. Sipas kësaj dispozite konventore, askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri, si dhe nuk duhet të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar. Gjithashtu në nenin 11 të saj, parashikohet e drejta për t'u organizuar në organizata punëmarrësish. Pra, Konventa në përmbajtjen e saj ka parashikuar një parim dhe të drejtë të rëndësishme të së drejtës së punës: ndalimin e punës së detyruar dhe të drejtën për t'u organizuar në mbrojtje të interesave të liria me punën. Karta Sociale Europiane siguron mbrojtjen efektive të të drejtave në fushën ekonomike dhe sociale, garantuar kjo e drejtë edhe nga neni 6.1 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe nga neni 15/1 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

Liria e ushtrimit të profesionit mund të kufizohet, vetëm nëse konsiderohet si e nevojshme për të mirën e përgjithshme. Mbrojtja e së drejtës kushtetuese kufizohet në parandalimin e detyrimeve që bien ndesh me Kushtetutën, sepse janë tepër të rënda dhe të papranueshme. Liria e zgjedhjes së profesionit mund të kufizohet vetëm nëse diçka e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e vlerave tepër të rëndësishme sociale. Nëse një cënim i tillë është i pashmangshëm, ligjvënësi duhet që të përzgjedhë atë formë të cënimit, që e kufizon sa më pak të jetë e mundur lirinë themelore. Nëse liria e zgjedhjes së profesionit çënohet nga vënia e kriterëve të caktuara për fillimin e ushtrimit të profesionit, duhet bërë dallimi mes kriterëve objektive dhe subjektive: për kriteret subjektive (veçanërisht për njohuritë paraprake dhe formimin profesional) është i vlefshëm parimi i proporcionalitetit në kuptimin që këto kritere nuk duhet të jenë në disproporcion me qëllimin që synohet të arrihet nëpërmjet aktivitetit të rregullt profesional. E

drejta e punës është trajtuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.⁶

Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në rezervë ligjore absolute ka lejuar kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutës vetëm me ligj për një interes publik ose në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë(*parimi i proporcionalitetit*) duke mos cënuar thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast pa tejkuluar kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut(*garant minimin KEDNJ*).

Në gjykimin parësor të këtij akti normativ, duke e nisur analizën ligjore nga neni 118 i Kushtetutës, Gjykata verifikon nëse ligji autorizues është shkelur në një nga kriteret që lidhen me kompetencën për nxjerrjen aktit administrativ, specifikimin e çështjeve që duhen rregulluar si dhe me parimet në bazë të të cilave nxirret akti nënligjor.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të evidentojë kuadrin ligjor që normon përcaktimin e kriterëve ligjore sa i përket ushtrimit të detyrës së drejtuesit teknik. Ligji nr. 105/2014 “*Për barnat dhe shërbimin farmaceutik*” përcakton në mënyrë shteruese të gjitha kriteret të cilat duhet të plotësojë drejtuesi teknik. Konkretisht kriteret e përcaktuara në ligj në nenin 29 të tij për drejtues teknik me shumicë janë:

- *Të zotërojë diplomë universitare;*
- *Të ketë përvojë pune prej dy vjetësh;*
- *Të jetë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.*

Në nenin 40 janë listuar kriteret ligjore për Drejtues Teknik Farmacie:

1. Drejtues teknik i farmacisë është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i huaj, që plotëson kërkesat e mëposhtme:

a) zotëron diplomë universitare të Fakultetit të Farmacisë; për shtetasit e huaj nevojitet njësimi i diplomës universitare nga autoriteti përgjegjës;

⁶ Çështja “Iversen kundër Norvegjisë”, datë 18.12.1963; Çështja “Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë”, datë 08.07.1994.

- b) ka një përvojë pune prej tre vjetësh në farmaci;
- c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve;
- ç) drejtuesi teknik i farmacisë e ushtron këtë rol vetëm për një farmaci ”.

Në nenin 5 të ligjit nr. 10171, datë 22.20.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë janë profesioni i:

- a) mjekut;
- b) stomatologut;
- c) farmacistit...”

Ndërsa në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se : “1. Të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar e ka çdo person, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj ose në ligje të tjera të veçanta. 2. Profesionin ushtronet si person fizik ose juridik, me cilësinë të vetëpunësuarit, sipas kërkesave të përcaktuara nga UP-ja përkatëse”.

Në nenin 31 të ligjit nr. 10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se:

1. Funkcionin e drejtuesit teknik të farmacisë e ushtron çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe çdo shtetas i huaj, që plotëson këto kushte:
 - a) ka arsimin e lartë për farmaci;
 - b) ka një përvojë pune prej dy vjetësh në farmaci;
 - c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.
2. Drejtuesi teknik i farmacisë e ushtron këtë rol vetëm për një farmaci dhe me kohë të plotë.
3. Farmacia lejohet ta ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.

Në kuptim të përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për urdhrin e farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve, si një nga organet e tij, ka në kompetencë ligjore të

përcaktojë kriteret për pranimin e farmacistëve në këtë urdhër, harton dhe miraton Kodin e Deontologjisë Farmaceutike si dhe statusin e urdhrit të farmacistëve.⁷ Ndërkohë në nenin 16 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve përcaktohet se: “Farmacistët në pension që nuk ushtrojnë profesionin, njihen si anëtarë të urdhrit pa qënë të detyruar të paguajnë kuotizacionin e anëtarësisë. Kur ata punësohen ose vetëpunësohen detyrohen të paguajnë edhe kuotizacionin e urdhrit...”.

Nga analiza në tërësi e dispozitave të lartëcituara vihet re se ligji nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për urdhrin e farmacistëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nuk e ka autorizuar Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve për të rregulluar me akt nënligjor çështjen e kriterëve lejuese të ushtrimit të detyrës së drejtuesit teknik, pasi kjo çështje është rregulluar dhe zgjidhur nga vetë ligji. Ligji organik nuk ka bërë diferencime në lidhje me ushtrimin e kësaj detyre me shkak ndalues mbushjen e moshës për pension pleqërie (përrjashtuar të vetëpunësuarit), duke u nisur nga parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, parime këto të trajtuara gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese.⁸ Atë që nuk ka dashur ta bëjë ligji, nuk mund ta bëjë akti nënligjor.

Nga interpretimi sistematik dhe afilimor i dispozitave të lartëcituara, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve nuk është autorizuar nga asnjë dispozitë ligjore të vendosë kriterë ndalues/përrjashtues lidhur me ushtrimin e detyrës së drejtuesit teknik. Ndryshimet e bëra në nenin 19 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, evidentojnë marrjen e kompetencës së ligjvënësit lidhur me kriteret e ushtrimit të detyrës së drejtuesit teknik, të cilat janë përcaktuar në mënyrë shteruese në nenet 29 dhe 40 të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”. Edhe ndryshimi i nenit 19 që lidhet me vendosjen e kriterit të ushtrimit të detyrës së drejtuesit teknik me kohë të plotë në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik, është një çështje që e ka rregulluar vetë ligji dhe për të njëjtat argument të parashtruara më lart ky parashkim tejkalon kompetencën e Këshillit Kombëtar dhe vetë përmbajtjen e ligjit.

Në këtë kuptim pala e paditur në nxjerrjen e aktit administrativ objekt gjykimi ka vepruar në kapërcim të kompetencave të dhëna nga ligji, fakt ky që e cilëson urdhrin objekt gjykimi

⁷ Neni 6, pika 3 në lidhje me nenin 12 të ligjit nr. 9150, datë 30.10.2003.

⁸ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.26, datë 02.11.2005, nr.33 datë 12.09.2007, nr.9, datë 23.03.2010.

absolutisht të pavlefshëm sipas shkronjës “b” të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative⁹ vetëm sa i takon ndryshimeve të nenit 19 të Statutit sa i përket kritereve të mëposhtme për të qënë drejtues teknik:

1-Të punojë me kohë të plotë vetëm në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik;

2-Të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve.

konstatim i cili bëhet edhe kryesisht nga gjykata. Kjo pavlefshmëri e pjeshme e aktit administrativ nuk e çënon në tërësi vlefshmërinë e aktit administrativ objekt gjykimi referuar parashikimit të nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit në qoftë se vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm në rast se pjesa që anulohet është aq e rëndësishme saqë pa të akti nuk e realizon qëllimin e tij. Kjo pavlefshmëri nga tërësia e dispozitave të ndryshimeve të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve për aq sa nuk është kundërshtuar nga palët në objektin e padisë, nuk është e nivelit që të pengojë realizimin e qëllimit të aktit normues.

Në përfundim të kësaj analize ligjore, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 49/2012 përfundimisht konkludon të pranojë padinë duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të Vendimit nr. 8, datë 29.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Republikës së Shqipërisë “Për disa shtesa në nenin 19 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë lidhur me detyrat e anëtarit”, vetëm sa i përket kritereve të mëposhtme për të qënë drejtues teknik: *1-Të punojë me kohë të plotë vetëm në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik; 2-Të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve.* Sipas nenit 102 dhe 106 të Kodit të Procedurës Civile, shpenzimet gjyqësore të përbëra nga taksa mbi aktet dhe njoftimet, i lihen në ngarkim pales së paditur.

PËR KËTO ARSYE

⁹ Neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: “Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;

b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapercim të kompetencave të tij ligjore;...

Gjykata Administrative e Apelit bazuar ne nenet 10, pika 2, shkronja "b", 40 pika 3, 41 e 42 te ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

V E N D O S I :

- Pranimin e padisë.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 8, datë 29.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Republikës së Shqipërisë "*Për disa shtesa-në nenin 19 të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë lidhur me detyrat e anëtarit*", vetëm sa i përket kritereve të mëposhtme për të qënë drejtues teknik:
1-Të punojë me kohë të plotë vetëm në farmacinë për të cilën aplikon si drejtues teknik;
2-Të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall në Tiranë, më 06.11.2015

GJYQTARE

GJYQTAR

GJYQTARE

Rilinda SELIMI

Artur MALAJ

Alkelina GAZIDEDJA

dv

dv

dv

GJYQTARE

GJYQTAR

Altina NASUFI

Kastriot SELITA

dv

dv



Vertetohet njesia me origjinalin